



KRIJIMI I RRJETIT TË MENTOREVE NË RAJONIN E OSBE-së:

Udhëzues praktik

Partnerët në projekt:

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)
dhe Qendra Daneze për Informim për Çështjet Gjinore, Barazi dhe Diversitet
(KVINFO)

Partner në financim:

Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë

Autor:

Qendra Daneze për Informim për Çështjet Gjinore, Barazi dhe Diversitet (KVINFO)

E publikoi Sekretariati i OSBE-së, Zyra SP/Departamenti për Barazi Gjinore

U shtyp në: Stanzell Druck, Vjenë, Austri
2014

Dizajni: Aurore de Boncourt

ISBN: 978-92-9234-547-1

Të gjitha qëndrimet, mendimet, linket dhe përfundimet e inkuorporuara në dokumentin „Krijimi i rrjetit të mentoreve në rajonin e OSBE-së: Udhëzues praktik“ i takojnë autorit dhe nuk do të thotë domosdosmërisht se OSBE-ja zyrtarisht i ka miratuar dhe përkrahur.

Ky publikim përmban faqe për prezantimet në internet që nuk i takojnë OSBE-së dhe të cilat i drejtojnë personat e tretë, ndërkaq mund të përmbajnë materiale që mbrohen nga e drejta e autorit ose nga të drejtat e tjera të personave të tretë. Duke marrë parasysh se OSBE-ja nuk i kontrollon këto prezantime në internet, nuk merr përsipër përgjegjësinë e as detyrimin ligjor për qasjen, saktësinë dhe tërësinë e përmbajtjeve të prezantimeve të jashtme në internet.

PËRMBAJTJA

PJESA 1

Vizioni - fq. 6

Modeli - fq. 7

Mentorimi dhe rrjetëzimi - fq. 8

Hapat kryesorë - fq. 9

PJESA 2 - MJETET

Regjistrimi - fq. 14

Intervista - fq. 16.

Marrëveshja për mentorim - fq. 21

Bashkimi në çift - fq. 23

Vlerësimi - fq. 27

Baza e të dhënave të mentorimit KVINFO - fq. 32

Bartja e përvojave në rrjetin e mentoreve: prania në mediat digjitale - fq. 33

Udhëzuesi për organizimin e punëtorisë hyrëse për nxënësë - fq. 34

Udhëzuesi për organizimin e punëtorisë hyrëse për mentore - fq. 39

Mentorimi dhe rrjetëzimi në politikë - fq. 43

Mentorimi dhe rrjetëzimi në ndërmarrësi - fq. 43

Lista finale e kontrollit për vendosjen e rrjetit të mentoreve - fq. 44

PJESA 3. - ANEKSET

Marrëveshja për mentorim - fq. 45

Qëllimi i marrëdhënieve të mentorimit - fq. 46

Përkujtuesi për nxënësë - fq. 47

PARATHËNIE

Numri mesatar i grave në pozita udhëheqëse dhe në pozita vendimmarrëse, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, dukshëm dallon ndër vendet anëtare të OSBE-së. Barazia sa i përket numrit të grave dhe burrave në bordet e korporatave ose ndër liderët ndërmarrës është arritur vetëm në një numër të vogël të mjediseve. Në shumicën e vendeve gratë, e veçmas ato nga popullata pakicë dhe e emigranteve edhe më tutje ballafaqohen me një sërë pengesash që kufizojnë qasjen e tyre në tregjet e punës dhe në fushat publike. Përderisa faktorët siç janë niveli i arsimimit dhe i qasjes në shërbimet për kujdesin ndaj fëmijëve që moti njihen si tejet të rëndësishëm ngase ua lehtësojnë grave realizimin e mundësive të ndryshme, për rolin e rrjetëzimit flitet shumë më pak.

Qendra Daneze për Informim për Çështjet Gjinore, Barazi dhe Diversitet (KVINFO) e ka shfrytëzuar drejtpërdrejtë rëndësinë e rrjetëzimit për gratë e marginalizuara duke e zhvilluar me sukses rrjetin e mentoreve në të cilin, deri në vitin 2002, janë përfshirë mbi 7000 gra. Modeli KVINFO është prezantuar si një shembull i praktikës së mirë se si duhet të fuqizohen gratë nga të gjitha komunitetet pakicë në konferencën „Gratë si bartëse të ndryshimeve në komunitetet pakicë dhe të emigranteve rome dhe sintia në hapësirën e OSBE-së“, të cilën e organizoi OSBE në Vjenë, më 6-7 shtator 2012.

Ky udhëzues praktik është rezultat i partneritetit ndërmjet Departamentit për Barazi Gjinore të OSBE-së dhe KVINFO, me qëllim që në tërë rajonin e OSBE-së të përhapen përvojat dhe leksionet që i ka mësuar organizata KVINFO. Është menduar si një doracak praktik për krijimin e rrjetit të mentoreve nëpërmjet ofrimit të synimeve operative, prezantimit të shembujve konkret dhe formularëve të dokumenteve të dobishëm për mentoret dhe nxënëset. Si i tillë, ky publikim ofron synimet për hartimin e marrëveshjes për veprimet e mentorimit, i cili ngërthen në vete rregullat themelore, çështjet e besueshmërisë dhe përgjegjësisë së mentores dhe nxënëses, si dhe është një softuer për bazën e të dhënave që e shfrytëzon KVINFO për përcjelljen dhe vlerësimin e rezultateve.

OSBE konsideron se ekskluziviteti mund t'i kontribuojë joqëndrueshmërisë dhe pasigurisë. Së këndejmi shpresoj se ky udhëzues praktik do të kontribuojë për t'i kuptuar më mirë vlerat strategjike të rrjetit të mentoreve për mënjanimin e përjashtimit social dhe fuqizimin e grave, veçmas të grave nga grupet e marginalizuara, duke ndikuar njëkohësisht në krijimin me sukses të rrjeteve të mentoreve në mbarë rajonin e OSBE-së.

Ambasadorja Miroslava Beham

Këshilltare e lartë për çështjet gjinore në OSBE

VIZIONI



„Barrierat shoqërore-ekonomike, stigmat shumëvjeçare kulturore dhe ligjet represive krijojnë sfida për gjithëpërfshirjen e grave në nivel global.“



Lamberto Zanijer
Sekretar i përgjithshëm i OSBE-së

Gjatë konferencës së OSBE-së me titull „Gratë si bartëse të ndryshimeve në komunitetet pakicë dhe të emigrantëve romë dhe sintia“ Vjenë, 2012, ekspertët konstatuan barriera dhe probleme të ndryshme ndërsektoriale që pengojnë fuqizimin e grave dhe përfshirjen e tyre të plotë në jetën publike në rajonin e OSBE-së. Me këtë rast janë vënë në pah shumë çështje, përfshirë edhe mungesën e qasjes në arsim, në kredi dhe në mbrojtjen shëndetësore.

Pjesëmarrësit u pajtuan se këto kufizime ndikojnë në masë të madhe në aftësinë e grave që të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën shoqërore. Po ashtu, ata u pajtuan se këto kufizime shkaktojnë tek gratë ndjenjën e izolimit dhe të privimit nga të drejtat e tyre.

Kur janë pyetur që të mendojnë se si do të mund të kapërceheshin në të ardhmen këto pengesa reciprokisht të ndërlidhura, u vërejt se pjesëmarrësit kishin një qasje unike: të krijohen rrjetet nëpërmjet të cilave gratë do të lidheshin, mësonin dhe shkëmbenin përvojat e tyre. Pjesëmarrësit kryesisht u pajtuan me faktin se krijimi dhe mbajtja e lidhjeve fleksibël të mentorimit paraqet një potencial të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve individuale të grave duke u dhënë atyre raste e mundësi të ndryshme që të mund t'i zbatojnë shkathtësitë dhe njohuritë e veta. Këto rrjete mund të jenë një kontribut i rëndësishëm për realizimin e objektivit të barazisë gjinore në nivel shoqëror, ekonomik dhe politik.

MODELI

Në vitin 2002, KVINFO - Qendra Daneze për Informim për Çështjet Gjinore, Barazi dhe Diversitet, e inicioi rrjetin e vet të mentorimit me qëllim që grave emigrante dhe refugjate që jetojnë në Danimarkë t'ua bëjë sa më të lehtë punësimin dhe integrimin në shoqëri.

Qëllimi kryesor i Rrjetit të mentorimit KVINFO është që t'i bashkojë gratë emigrante dhe refugjate (nxënëse) me gratë që kanë një pozitë stabile në shoqërinë daneze (mentoret) si dhe në tregun danez të punës.

Marrëdhëniet e mentorimit mbështeten në vlera të qarta dhe janë të orientuara në ngjashmëritë ndërmjet grave, e jo në dallimet e tyre. Në praktikë ato përbëhen nga takimet „një për një“ në të cilat mentorja dhe nxënësja trajtohen në mënyrë të barabartë. Mentorja dhe nxënësja ndërlihen në pajtim me arsimimin dhe përvojën profesionale të nxënësës si dhe me dëshirat dhe qëllimet e saj personale. Qëllimi i marrëdhënies së tyre është që nxënësës t'i ofrohet ndihma e duhur në mënyrë që ajo ta shfrytëzojë tërë potencialin e vet për t'i arritur qëllimet që i ka sa i përket jetës së saj në Danimarkë.

Sot në rrjet janë të lidhura mbi 7000 pjesëmarrëse dhe sipas mendimit të

ekspertëve të mentorimit dhe aftësimit, ky përbën rrjetin më të madh të këtij lloji në botë.

Modeli KVINFO sot konsiderohet si shembull i „praktikës së mirë“ nga i cili mund të mësojnë të tjerët, përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare, siç është Komisioni Evropian për Punësim, Politikë Sociale dhe Mundësi të Barabarta, Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Lobi i Grave të Evropës (EWL) dhe iniciativa kanadeze „Qytetet e emigrimeve“.

Rrjeti i mentoreve KVINFO ka inspiruar sektorët e tjerë në Danimarkë që të themelojnë rrjete të ngjashme, kështu që kjo ide madje i ka kaluar kufijtë e vendit dhe është shtrirë edhe në Norvegji, Islandë, Finlandë, Gjermani, Spanjë, Portugali, Belgjikë, Butan, Tanzani, Malavi, Jordani, Tunizi dhe Maroko.

Udhëzuesi praktik është hartuar ashtu që të aplikohet nga operacionet në terren të OSBE-së dhe partnerët e saj për krijimin e rrjetit të mentoreve sipas modelit të Rrjetit të mentoreve KVINFO. Është menduar si e tillë që të sigurojë njohuri praktike dhe qasje në çështjet e mentorimit me qëllim të zhvillimit të një pune profesionale në këtë fushë.

MENTORIMI DHE RRJETËZIMI?

Pjesa më e madhe e literaturës në dispozicion i ka rrënjët e konceptit të mentorimit në mitologjinë e vjetër greke. Mirëpo, në kohët moderne mentorimi formal shfrytëzohet mjaft efektivisht në arsimin e lartë, në qeverisje e në sjelljen organizative, në psikologji, në kujdesin social dhe në shumë fusha të tjera.

Mentori është ai që jep direktiva, udhëzime, modele, këshilla dhe, sipas mundësisë, sponsoron. Tradicionalisht, në procesin e mentorimit janë përfshirë dy individë, mentori dhe nxënësi, ndërkaq mentorimi kuptohet si një marrëdhënie e ndërsjellë i cila u mundëson të dy palëve që të përjetojnë zhvillimin dhe transformimin e vet.

Liderët e mëdhenj në industri dhe njerëzit me dhunti në të gjitha fushat gjithmonë kanë pasur mentorë, shpeshherë më shumë se sa një, ndërkaq në shumë ndërmarrje praktikantët menaxherialë punojnë së bashku me udhëheqësit më të lartë. Mirëpo, nxënësi mund të përfitojë nga ndihma e mentorit vetëm nëse ekzistojnë individë dhe organizata që besojnë në potencialin e tij.

Filozofia mentoruese KVINFO nënkupton besimin tek gratë që janë nxënëse – KVINFO, tek ato sheh gra me resurse dhe kapacitete të pashfrytëzuara.

Rrjetëzimi është akt i lidhshmërisë!

Termi „rrjet“ vjen nga fusha e informatikës. Përdoret për përshkrimin e aktit të lidhshmërisë së dy aparateve kompjuterike ose më shumë sish me qëllim të shkëmbimit të të dhënave. Në fushën profesionale, rrjeti është një grup i bashkëvendimtarëve të cilët krijojnë mundësi dhe ndërmarrin aksione. Rrjetet kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin individual dhe profesional.

Qasja e KVINFO ndaj rrjetëzimit ka dy karakteristika kryesore: shkëmbimin e informatave dhe mundësinë e veprimit atëherë kur krijohen rrethanat e përshtatshme. Rrjeti i mentoreve KVINFO shkëmben kontaktet dhe njohuritë ndërmjet grave të cilat mund të përfitojnë nga lidhshmëria e ndërsjellë.

1

Të kuptuarit se ekziston nevoja për një program të tillë.

Kjo gjithsesi është jashtëzakonisht e rëndësishme. Objektivat e përgjithshme dhe ato të veçanta duhet patjetër të përkufizohen mirë që nga fillimi, por edhe shfrytëzuesit e ardhshëm të tij. Kërkimet tregojnë se problemi më i madh i gruas emigrante dhe refugjate e cila jeton në Danimarkë është që të gjejë një punë që i përgjigjet përvojës së saj profesionale. Vlerësohet se më shumë se 50% e vendeve të lira të punës në Danimarkë plotësohen nëpërmjet rrjeteve individuale. Rrjetet janë me rëndësi thelbësore për të gjetur mbështetje në shoqërinë daneze. Nëpërmjet takimeve „një për një“ individë të barabartë, mentorët daneze sigurojnë qasjen në rrjetet e veta dhe mund të ofrojnë këshilla përkatëse në lidhje me aplikimet për punë, intervistat për punë, kulturën e punës dhe vlerësimin e potencialeve për punësim.

Objektivi kryesor i përgjithshëm dhe objektivat e veçanta duhet të jenë të lidhur me një kornizë të caktuar kohore.

Janë nevojitur së paku 12 muaj në mënyrë që programi pilot Rrjeti i mentoreve KVINFO të dëshmohej si i suksesshëm. Siç duket, marrëdhëniet e mentorimit kanë një cikël jetësor të natyrshëm: inicimin, kultivimin, pjekurinë, ndarjen dhe përkufizimin e sërishëm. Korniza kohore e secilës fazë varet nga struktura e programit dhe nga menaxhimi i programit.

2

Përcaktimi i resurseve të nevojshme për përkrahjen e programit me këtë kohëzgjatje.

Pasi të përcaktohen rezultatet e pritshme është e domosdoshme që të përcaktohen edhe planet dhe resurset e nevojshme për zbatimin e programit: personeli, buxheti, procesi i punës, korniza kohore, plani i komunikimit dhe mënyra e vlerësimit. Për shkak të konsultimeve të vazhdueshme gjatë procesit të bashkëveprimit ndërmjet mentores dhe nxënëses, Rrjetit të mentoreve KVINFO i janë nevojitur së paku dy anëtarë të personelit për koordinimin e një numri të madh të partnerëve – mentoreve dhe nxënëseve. Këta të punësuar quhen koordinatorë, kanë përvojë në zhvillimin e intervistave dhe i posedojnë shkathtësitë themelore të punës në kompjuter për ta shfrytëzuar bazën e të dhënave të mentorimit. Rekomandohet që të caktohet një hapësirë fizike në të cilën koordinatorët mund ta organizojnë rrjetin që intervistat t'i zhvillojnë në mënyrë të besueshme. Po ashtu, një prej resurseve të rëndësishme mund të jetë edhe qasja në bazën e të dhënave.

3

4

Po ashtu, është tejet e rëndësishme mënyra se si do të përzgjidhen mentoret dhe nxënëset.

A do të aplikojnë mentoret dhe nxënëset që të jenë pjesë e rrjetit? Në çfarë mënyre do të përzgjidhen? Mentoret e para të KVINFO kanë qenë vullnetare, të cilat janë paraqitur pasi që kjo ide është publikuar nëpërmjet regjistrave të adresave të postës elektronike dhe në faqen e internetit KVINFO. Mentoret janë gra të fuqishme, të arsimuara, me ndikim, të lidhura me njerëz me ndikim që i takojnë rrjetit të gjerë të kontakteve KVINFO. Mirëpo, sfida kryesore ishte depërtimi deri te nxënëset potenciale – emigrante dhe refugjate. KVINFO filloi duke e inicuar projektin pilot me qëllim të bashkimit të 12 çifteve të mentoreve dhe nxënëseve, ndërkaq zbuloi se kontakti me nxënëse mund të vendoset nëpërmjet forumeve, shoqërive dhe shoqatave që nganjëherë janë tejet të pakëta. Nga kjo pikë fillestare, nëpërmjet rrjeteve personale u përhap zëri se rrjeti i mentoreve mund të funksionojë dhe të arrijë rezultate të shkëlqyeshme. Tani shumë gra, pasi janë informuar nga të tjerët, i drejtohen KVINFO duke shfaqur dëshirën e vet që të integrohen në këtë rrjet.

5

Të caktohet mënyra e përzgjedhjes dhe bashkimit në çifte të mentoreve dhe nxënësve.

KVINFO ka përgatitur intervista individuale që ndihmojnë në ndërtimin e profileve personale të mentoreve dhe nxënësve. Profilët përmbajnë të dhëna për arsimimin dhe përvojën e punës, objektivat profesionale dhe jetësore, përparësitë, dobësitë dhe pritshmëritë. Këto të dhëna ndihmojnë në orientimin e procesit të bashkimit në çifte. Kur koordinatorja e KVINFO e interviston një nxënës, pyetjet orientohen në atë që ajo do të dëshironte të punonte, cilat janë ëndërrat e saj për jetën në Danimarkë, çfarë lloj trajnimi dhe pune do të dëshironte si dhe cila mentore do t'i pëlqente më shumë. Kriteret në bazë të të cilave bashkohen mentorja dhe nxënësja përfshijnë edhe llojin e përbashkët të punës dhe përvojat e përbashkëta mbi të cilat do të ndërtohet marrëdhënia e tyre. Përvoja e përbashkët siguron platformën për një dialog dhe bashkëpunim që duhet të jenë në dobi të mentores dhe nxënësës. KVINFO konsideron se kjo perspektivë është me rëndësi thelbësore.

Të caktohet se kur dhe ku do të zhvillohet mentorimi.

Rrjeti i mentoreve KVINFO propozon që të mbahet takimi i parë ndërmjet mentores dhe nxënësës, në të cilin do të diskutohen opsionet, pastaj duhet t'u jepet rasti që të mendojnë se a do të dëshironin që të vendosnin marrëdhënien e mentorimit për një periudhë njëvjeçare. Takimi duhet të zhvillohet në terren neutral, për shembull, në bar kafe ose në bibliotekën lokale. Po që se pajtohen që të vazhdojnë kontaktet, atëherë në takimin e dytë mentores dhe nxënësës u jepet marrëveshja për mentorim dhe plani i aktiviteteve. Që të dy këto mjete mund të përdoren si udhërrëfyes, por më së miri është që vetë çiftet mentoruese të caktojnë orarin i cili u përgjigjet nevojave të tyre. KVINFO vazhdimisht ia përkujton çiftit të mentorimit përkushtimin e tyre ndaj procesit të mentorimit por, njëkohësisht, ua mundëson që vetë të vendosin për kohën që janë të gatshëm t'ia kushtojnë kësaj marrëdhënieje.

6

Ngjarjet dhe mundësitë lidhur me rrjetëzimin duhet të ofrohen në vazhdimësi.

Çiftet e mentorimit mund të takohen në sesione të përbashkëta të rrjetëzimit. Këto ngjarje të rrjetëzimit planifikoni duke u mbështetur në mentoret dhe nxënëset në mënyrë që të keni qasje dhe ide më të mira për temat që do të shqyrtohen në punëtori, në seminare dhe gjatë vizitave në terren. Nganjëherë disa prej nxënëseve të cilat i bashkëngjiten Rrjetit të mentoreve KVINFO, luftojnë me depresionin e shkaktuar nga izolimi i gjatë social. Duke pasur parasysh një situatë të tillë, vlen të theksohen qëllimet „më të buta“ të rrjetëzimit – ato kahje të veprimit që janë me rëndësi thelbësore për gjetjen e grave të tjera dhe vendosjen e lidhjes me to, si dhe me qëllim të hyrjes në fushat e ndryshme shoqërore – për shembull, avancimi i shkathtësive gjuhësore.

Punëtoritë për orientimin fillestar u ofrojnë mentoreve dhe nxënëseve një mundësi të rëndësishme që t'i kuptojnë objektivat e programit dhe që t'i paraqesin pritshmëritë e tyre.

KVINFO përkrah punëtoritë e veçanta në të cilat i orienton mentoret dhe nxënëset e reja dhe secilës pjesëmarrëse ia ofron mundësinë që t'i shpreh pritshmëritë e veta dhe të shtrojë pyetje. Mentoret dhe nxënëset e marrin doracakun me informata të hollësishme e të dobishme.

Dokumentacioni i rregullt dhe përcjellja e përparimit të çifteve të mentoruara.

KVINFO ka krijuar bazën e të dhënave në të cilën regjistrohen kontaktet ndërmjet koordinatoreve e mentoreve dhe nxënësive. Një pjesë e rëndësishme e punës së koordinatores është që të konstatojë se si po përparojnë marrëdhëniet, të ofrojë përkrahjen e nevojshme dhe që t'i zgjidhë çështjet në rast të konflikteve.

Vlerësimi i rezultateve dhe sigurimi i mekanizmit në bazë të të cilit mentoret dhe nxënëset vlerësojnë përvojën e vet janë çështjet kyçe për realizimin e plotë të programit.

Që nga fillimi i Rrjetit të mentoreve KVINFO, norma zyrtare e suksesit është përkufizuar si numri i bashkimit në çifte, e jo si norma e punësimit të nxënësive. KVINFO i konsideron të suksesshme rastet në të cilat mentorja dhe nxënësja e përfundojnë tërë ciklin e mentorimit gjatë periudhës njëvjeçare, ndërkaq rezultatet tregojnë shumë më tepër se sa punësimi. Raporti i vlerësimit i organizatës së pavarur daneze Oxford Research, që është orientuar në mirëqenie, industri dhe zhvillim rajonal, tregon sa vijon:

- 29% e nxënësive thonë se rrjeti u ka dhënë mundësi më të mira që të hyjnë në tregun e punës.
- 55% pohojnë se janë bërë më të suksesshme në të gjitha përpjekjet për arsimim.
- 61% pohojnë se i kanë përmirësuar mundësitë e veta që ta kryejnë arsimin.
- Shumë nxënës deklarojnë se tani kanë shumë më tepër njohuri për shoqërinë daneze (72%), se e flasin më mirë gjuhën daneze (55%) dhe se tani besojnë më tepër në vetvete dhe në zotësitë dhe shkathtësitë e veta (71%).

Informatat e gjithmbarshme kthyesë nga mentoret dhe nxënëset e Rrjetit të mentoreve KVINFO tregojnë se i tërë procesi është jashtëzakonisht pozitiv.

MJETET

REGJISTRIMI

Në vitin 2002, mentoret janë paraqitur vullnetarisht posa KVINFO e ka publikuar projektin në faqen e vet të internetit dhe nëpërmjet regjistrave të ndryshëm të adresave të postës elektronike. Kontakti me nxënëset është vendosur nëpërmjet promovimit të idesë për Rrjetin e mentoreve përmes forumeve, shoqërive dhe shoqatave të vogla. Pikërisht nga kjo pikënisje shumë shpejt u përhap lajmi se Rrjeti i mentoreve funksionon.


Tani, Rrjeti i mentoreve nuk ka nevojë për ndonjë aktivitet të veçantë për të depërtuar deri te shfrytëzuesit – ngase rrëfimet për rastet e suksesshme barten nga një person tek tjetri, ndërsa emigrantet kontaktojnë me rrjetin me iniciativën e vet. Mentoret dhe nxënëset regjistrohen nëpërmjet faqes së internetit. Koordinatorja personalisht i orienton ato që kanë probleme me regjistrimin nëpërmjet internetit. Pas regjistrimit e marrin porosinë elektronike me të cilën konfirmohet aplikimi, primaju elektronsku poruku kojom se potvrđuje prijava.




Ju falënderojmë që keni aplikuar në Rrjetin e mentoreve: Kemi kënaqësinë që dëshironi të merrni pjesë në Rrjetin e mentoreve si: nxënëse/mentore. Për ta konfirmuar regjistrimin shkoni në: www.mentornet.com.


Nëse dëshironi ta konfirmoni regjistrimin, nuk keni nevojë të bëni asgjë. Regjistrimi Juaj do të aktivizohet pasi ta bëni konfirmimin.

*Ju përshëndesim përzemërsisht
Kordinatorja
Rrjeti i mentoreve*

 Pasi të konfirmohet regjistrimi, baza e të dhënave u bën të mundur koordinatoreve që t'i përpunojnë profilet e nxënësve dhe mentoreve, si dhe të ndihmojnë në procesin e bashkimit në çifte. Secili profil individual përmban një sërë të dhënash të ndryshme, të cilat janë të detyrueshme ose opsionale.

Pastaj njëra prej koordinatoreve zgjedh profilin individual të mentores ose të nxënëses dhe e ndryshon statusin e saj në bazën e të dhënave:

 Ndryshimi i statusit nga « E REGJISTRUAR » në « PRET INTERVISTIMIN »

 Pastaj, mentoret dhe nxënëset veç e veç e marrin porosinë elektronike që të paraqiten për intervistim individual. Ky është një shembull i thirrjes për nxënëset.



E nderuara {emri}

Keni aplikuar që të bëheni anëtare e Rrjetit të mentoreve andaj dëshiroj t'ju ftoj për intervistim. Gjatë intervistës do të bisedojmë për profilin tuaj profesional dhe personal dhe për dëshirat tuaja si mentore. Intervista do të mbahet (muaji/dita/data). Luteni që të paraqiteni në (adresa), ku do t'ju presë në kohën e caktuar.

Luteni që ta konfirmoni ardhjen tuaj nëpërmjet postës elektronike ngase, në të kundërtën, këtë kohë mund ta shfrytëzojmë për intervistimin e ndonjë personi tjetër. Nëse nuk keni mundësi të vini në ditën e caktuar, lirisht na shkruani dhe propozojeni ndonjë datë tjetër.

Ju dëshiroj mirëseardhje në takim!

*Kordinatorja
Rrjeti i mentoreve*

INTERVISTA

 **Për të gjitha mentorët dhe nënëset intervista është e detyrueshme.**

KVINFO e shfrytëzon Udhëzuesin për intervistim, i cili përmban pyetjet e hartuara me qëllim që të merren informatat për fushat kyçe, për shembull - lidhur me motivimin, profilin profesional dhe qëndrimin ndaj mentorimit dhe bashkimit në çifte.

Këto fusha janë shënuar sipas radhës që do ishte logjike për shumicën e mentoreve dhe nxënësve. Mirëpo, koordinatorja gjithmonë duhet ta analizojë se a është kjo radhitja më funksionale për nxënësen dhe mentoren e cila intervistohet, kështu që sipas nevojës duhet ta përshtatë.

Koordinatorja mund t'i shtrojë të gjitha këto pyetje, edhe pse rrallëherë kjo do jetë e nevojshme. Shtruarja e pyetjeve për fushat për të cilat mentorët dhe nxënëset tanimë kanë dhënë përgjigje mund të konsiderohet veprim i pakujdesshëm. Koordinatorja duhet t'i zgjedhë pyetjet për të cilat mendon se janë më të përshtatshme dhe t'i plotësojë ato me pyetje shtesë, nëse kjo është e nevojshme.

KVINFO propozon këto drejtime për intervistim:


- **Gjatë intervistimit, koordinatorja i shënon përgjigjet e dhëna.**

Koordinatorja duhet të përpiqet të vendosë një lidhje sa më të mirë me gruan të cilën e interviston dhe të krijojë një ndjenjë sa më pozitive në kontaktin e tyre të ndërsjellë.

Është e nevojshme që koordinatorja t'i jep kohë të mjaftueshme nxënëses/mentores që të mendojë para se të përgjigjet.

- **Intervistat janë gjithmonë stresuese.**

Nëse koordinatorja dëshiron ta orientojë gruan në ndonjë shërbim të veçantë social ose të theksojë diçka plotësuese, këtë duhet ta shënojë dhe të theksojë në përfundim të intervistës. Është me rëndësi që të intervista të jetë e këndshme dhe të ketë rrjedhë normale.

 **Nëse intervista ka qenë tepër stresuese** për shkak të zbulimit të informatave inkriminuese apo nëse ka qenë tejet emotive për personin e intervistuar, atëherë këtë duhet më vonë ta shqyrtojë me kolegen dhe t'i analizojnë mundësitë e veprimit në situatën konkrete.



Shembull i Udhëzuesit për intervistimin e pjesëmarrëseve

Mirëseardhja dhe prezantimi i personit i cili bën intervistimin:

*Informatat për strukturën e bisedës.
Informatat për besueshmërinë e bisedës. Nëse është e nevojshme, një hyrje e shkurtër për rrjetin e mentoreve: qëllimet, synimet, vlerat, madhësia, aktivitetet, marrëdhënia e mentorimit etj.*

Profili profesional:

*A mund të na tregoni diçka për arsimimin tuaj (në vendin amë + në vendin e ri);
A mund të na tregoni diçka lidhur me përvojën e punës suaj (në vendin amë + në vendin e ri);
Çfarë është përvoja juaj sa i përket kërkimit të punës në vendin e ri?
A mund të na thuani diçka më tepër lidhur me këtë;
Cilën punë shpresoni ta gjeni në të ardhmen?
Cilat gjuhë i flisni?*

Profili personal:

*KKur keni ardhur në këtë vend dhe cilat janë arsyet e ardhjes suaj?
Si keni ardhur këtu?
Me të cilat pengesa jeni ballafaquar në vendin e ri (sa i përket punësimit, arsimimit dhe komunikimit me*

organet)?

*Si do ta përshkruanit veten si person?
Apo si do të ju përshkruanin miqtë juve si person, çfarë mendoni se do të thonin?*

Rrjetet:

*A njihni shumë njerëz në vendin e ri?
Kush janë ata (familja, kolegët, miqtë etj.)?
Si jeni njoftuar me ta?
A ka ndonjë vendas ndër miqtë Tuaj?*

Vizioni:

*Cilat kanë qenë ëndërrat Tuaja para se të vini në vendin e ri?
Cilat kanë qenë ëndërrat Tuaja menjëherë pas ardhjes suaj në vendin e ri?
Tani, cilat janë ëndërrat Tuaja?
Sikur ta kishit lirinë e plotë të vendimmarrjes – si do të dukej jeta Juaj pas 5 vitesh?
Çfarë duhet të bëni që këtë ta realizoni?*

Bashkimi në çift:

*Pse dëshironi ta keni mentoren?
Çfarë rezultati shpresoni të arrini nga kjo marrëdhënie?
Çfarë përкраhe do të dëshironit nga mentorja?
Çfarë mendoni se Ju dhe mentorja*





*Juaj do të duhej të punoni së bashku?
Çfarë mund t'i ofroni marrëdhënies së
mentorimit?*

*Cila do ishte mentorja ideale për Ju?
Cila është përvoja dhe arsimimi i saj
dhe ku punon?*

*Sa shpesh mund të takoheni me
mentoren?*

*A keni ndonjë lloj kërkesë sa i përket
mentores, pos atyre profesionale
(pleqëria, fëmijët, punët, arsimimi,
interesat, rajoni gjeografik)?*

Të tjera:

*A ka diçka tjetër që do të duhej ta
dijë për Ju në mënyrë që t'ua gjejë
mentoren përkatëse?*

*A ekziston diçka me çka do të mund
t'i kontribuoni aktiviteteve të rrjetit të
mentoreve?*

A keni ndonjë pyetje për mua?

Pastaj i merr informatat lidhur me atë se si vazhdon procesi:

*Koordinatorja i ndërmerr këta hapa
pas intervistës:*

*Kërkimi i çiftit përkatës. Bashkimi
në çift. Takimi i parë. Informata
kthyesë nga takimi. Marrëveshja për
mentorim dhe plani i aktiviteteve.*

*Koordinatorja përcjell dhe verifikon.
Informata kthyesë, kur çifti arrin
ndonjë qëllim. Vlerësimi. Përfundimi
i bashkimit në çift. Doracaku.
Informatat për kurset, ngjarjet dhe
buletinin informativ.*

Hyrje:

*Informatat për strukturën e bisedës.
Informatat për besueshmërinë e
bisedës. Po që se është e nevojshme,
një prezantim i shkurtër për rrjetin e
mentoreve: qëllimet, vlerat, madhësia,
aktivitetet, marrëdhënia e mentorimit
etj. Si jeni informuar për rrjetin e
mentoreve?*

Motivimi:

*Pse dëshironi të jeni mentore?
Çfarë mendoni se do të përfitonin si
mentore?*

Profili profesional:

*Nëse do t'ju përshkruanin miqtë, çfarë
do të thonin (lëvddata/kritika)? Si do të
dukej jeta juaj ideale pas 5 vitesh? Cili
është hobi juaj?*

Profili personal:

*Nëse do t'ju përshkruanin miqtë, çfarë
do të thonin (lëvddata/kritika)? Si do të
dukej jeta juaj ideale pas 5 vitesh? Cili
është hobi juaj?*

Rrjetet:

*Cilat janë kontaktet tuaja dhe të
rrjetit? Si mendoni ta shfrytëzoni
rrjetin tuaj në raport me nxënësen?*



Bashkimi në çift:


Çfarë mund t'i ofroni nxënëses? A keni menduar se me kë mund t'ju bashkoinë në çift, e me kë nuk do të duhej t'ju bashkoinë? Sa takime në muaj mund t'i keni me nxënësen? A keni ndonjë dëshirë sa i përket pleqërisë apo gjendjes martesore? A ka diçka tjetër që do të duhej ta di për Ju në mënyrë që t'ju bashkojë sa më mirë me nxënësen?

Të tjera:

A ekziston diçka me çka do të mund t'i kontribuoni aktiviteteve të rrjetit të mentoreve (njohuritë specifike, shkathësitë që do të dëshironit t'i shfrytëzonit, prezantimet, punëtoritë)?

Të tjera:

A keni ndonjë pyetje për mua? Pastaj mentorja merr informatat lidhur me atë se si do të vazhdojë procesi: Kërkimi i çiftit përkatës. Bashkimi në çift. Takimi i parë. Informata kthyesë nga takimi. Marrëveshja për mentorim dhe plani i aktiviteteve. Koordinatorja përcjell dhe verifikon. Informata kthyesë, kur çifti arrin ndonjë qëllim. Vlerësimi. Përfundimi i bashkimit në çift. Doracaku. Informatat për kurset, ngjarjet dhe buletinin informativ.


 **Është me rëndësi të mbahen shënime të mira në të cilat do të theksohet përmbajtja e intervistës.**

Shembulli i të dhënave që duhet të merren gjatë intervistës:

Data
Personi i cili e zhvillon intervistën
Njohuritë për Rrjetin e mentoreve
Profili personal
Profili profesional
Rrjeti
Vizioni
Bashkimi në çift
Të tjera

Është rregull i përgjithshëm që koordinatorja duhet të sjellë këto materiale në intervistë:


Udhëzuesin për zhvillimin e intervistës
Profilet e nxënësve ose të mentores
Broshurën për Rrjetin e mentoreve
Kartëvizitën
Marrëveshjen e mentorimit
Planin e aktiviteteve

 **Koordinatorja gjithmonë duhet t'ua shpjegojë** pjesëmarrëseve potenciale se bashkimi në çift bëhet në bazë të nevojave specifike; së këndejmi, nuk është e mundur që gjithmonë të gjendet mentorja e duhur ndër të gjitha ato që janë në dispozicion.

 **Koordinatorja gjithmonë duhet**

t'ua shpjegojë mentoreve potenciale se bashkimi në çift bëhet në bazë të nevojave specifike; së këndejmi, ndoshta secila mentore nuk do të bashkohet me sukses në çift. Po ashtu, mentorja duhet ta dijë se ajo menjëherë nuk bëhet anëtare e Rrjetit dhe se të dhënat për të ruhen në bazën e të dhënave të programit për nxënëset e ardhshme.

Pas përfundimit të intervistës dhe hartimit të profileve individuale, statusi i mentores ose i nxënësës në bazën e të dhënave sërish ndryshohet:

 **Ndryshimi i statusit nga «PRET TË INTERVISTOHET» në «E GATSHME PËR BASHKIM NË ÇIFT»**

MARRËVESHJA PËR MENTORIM

Është tejet e rëndësishme që mentorja dhe nxënësja t'i formulojnë pritshmëritë dhe qëllimet e veta sa i përket marrëdhënies së ndërsjellë në mënyrë që të vendoset një themel i fortë për zhvillimin, mësimin e ndërsjellë dhe dialog të barabartë. KVINFO ka hartuar Marrëveshjen për mentorim me qëllim që mentorja dhe nxënësja t'i kuptojnë sa më lehtë rregullat themelore që kanë të bëjnë me besueshmërinë dhe përgjegjësitë që dalin nga marrëdhënia e tyre. Koordinatorja duhet ta sjellë në intervistë një kopje të marrëveshjes dhe të japë shpjegime se si shfrytëzohet, në pajtim me atë që është theksuar në vazhdim. Kjo është një marrëveshje e jo kontratë, kështu që është në interesin e mentores dhe nxënësës që për të të bisedojnë dhe të arrijnë mirëkuptimin për secilën prej këtyre pyetjeve kyçe pasi që bashkimi në çift të konfirmohet:



Kështu duket marrëveshja e mentorimit ndërmjet nxënësës dhe mentores. Janë theksuar disa prej përgjegjësisve që i ka secila prej tyre.

Kërkesat për mentoren:

- Dëgjo, shtro pyetje, oriento dhe bëhu partnere;
- Bëhu bashkëbiseduese e sinqertë;
- Shpreh respektin;
- Bëhu e gatshme që personit tjetër t'ia bësh të mundur qasjen në rretet tua personale;
- Mentorja nuk mund dhe nuk duhet të bëhet eksperte për çdo gjë.

Kërkesat për nxënësen:

- Shtro pyetje, dëgjo dhe bëhu e hapur për këshilla dhe orientime;
- Merr përsipër përgjegjësinë dhe iniciativën për zhvillimin tënd;
- Shpreh respektin;
- Bëhu bashkëbiseduese e sinqertë;
- Nxënësja do duhej të përpiqej t'i realizonte qëllimet e nevojat e veta dhe të jetë e gatshme që për to të bisedojë;
- Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, mentorja dhe nxënësja shprehin pëlqimin e vet për sa vijon;
- Takimet tona janë të besueshme;



- *Nuk shkëmbejmë dhurata dhe nuk i huazojmë para njëra tjetrës;*
- *Mentorja angazhohet maksimalisht që ta mbështes nxënësen dhe ta ndihmojë që ta zgjetojë rrjetin e vet;*
- *Do të takohemi së paku njëherë në muaj deri në përfundim të mentorimit;*
- *Do t'i përmbahemi marrëveshjes në lidhje me takimet dhe do të paraqitemi me kohë;*
- *Nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e marrëveshjes, këtë do ta bëjmë me shkrim dhe për këto ndryshime do ta njoftojmë koordinatoren;*
- *Ndërmjet takimeve do të komunikojmë nëpërmjet telefonit/postës-e/porosive sms dhe këtë në intervalet prej_____;*
- *Pritshmëritë e nxënëses nga marrëdhënia e mentorimit (përpiquni që të jeni sa më konkrete):*
- *Pritshmëritë e mentores nga marrëdhënia e mentorimit (përpiquni që të jeni sa më konkrete).*


Prishja e marrëveshjes:

- *Secila palë mund ta prishë marrëveshjen duke e respektuar afatin njëmuajor, ndërsa java e fundit do të shfrytëzohet për evaulimin e marrëdhënies së mentorimit. Mirëpo, mentorja dhe nxënësja mund të prishin marrëdhënien e mentorimit edhe me afat njëditor, nëse pala tjetër e ka shkelur marrëveshjen. Nëse ndodhë cenimi i besueshmërisë, marrëveshja e mentorimit prishet menjëherë.*
- *Marrëveshja do të revidohet së paku njëherë në vit. Nëse nxënësja ose mentorja konsideron se pritshmëritë e saj janë plotësuar para vlerësimit vjetor, marrëveshja mund revidohet menjëherë. Kur marrëveshja është vlerësuar ndërsa marrëdhënia e mentorimit është vlerësuar, palët në marrëveshje mund të bisedojnë se a do të vazhdojnë të takohen, dhe nëse vendosin të vazhdojnë, a do ta lidhin një marrëveshje të re apo do ta ndërprejnë marrëdhënien e mentorimit.*

Shih shembullin e Marrëveshjes së mentorimit KVINFO në Aneksin I (fq. 45)

BASHKIMI NË ÇIFT

Secila koordinatore e KVINFO-s është e angazhuar për 80 çifte në vit.

 **E para**, koordinatorja e dërgon porosinë elektronike në të cilën propozon bashkimin potencial në çift të metores dhe nxënëses.



Propozoj bashkimin potencial në çift për mentorim. Hapi i ardhshëm është që të takoheni dhe të bisedoni për atë se a përputhen pritshmëritë tuaja dhe se a jeni të gatshme të lidheni për një periudhë kohore. Detyra e juaj tani (nxënëse) është që të kontaktoni me (mentoren) dhe të merreni vesh për takimin e parë. Datën e takimit të parë duhet ta caktoni së bashku brenda afatit prej 14 ditësh, ndërsa takimi duhet të mbahet brenda afatit prej dy muaj nga dita e sotme.

Të dhënat për kontaktim:

> MENTORJA • Emri • Adresa • Telefoni • Mobil • E-mail

> NXËNËSJA • Emri • Adresa • Telefoni • Mobil • E-mail

Takimi i parë nuk është detyrues, ndërkaq pas kësaj ju rekomandojmë që të dyjat të mendoni mirë e mirë për këtë përvojë. Pastaj secila prej jush do të duhej të më lajmërohej dhe të më njoftojë se a do të dëshironte që ta vazhdojë këtë marrëdhënie të mentorimit apo jo.

Kjo do të thotë se gjatë takimit të parë nuk duhet të caktohet takimi i ri. Nëse të dyjat dëshironi ta vazhdoni procesin formal të mentorimit, do t'ju përgjigjem dhe do t'ju japë lajme të mira.

Nëse nuk dëshironi ta vazhdoni këtë marrëdhënie, do ta gjejë një mentore ose nxënëse të re për secilën prej jush.

Ju rekomandoj që të mos e plotësoni marrëveshjen dhe planin e bashkëngjitur para se ta merrni vendimin përfundimtar për vazhdimin e marrëdhënies së mentorimit, apo edhe të ndonjë takimi tjetër.

Ju dëshiroj mirëseardhje në takim!

*Me respekt,
Koordinatorja
Rrjeti i mentoreve*

Koordinatorja pastaj duhet ta shënojë datën e re për verifikimin e bazës së të dhënave, zakonisht pas dy javësh.

Me sa duket **Çelësi i bashkimit me sukses në çift** është gatishmëria e mentores dhe e nxënëses që të marrin pjesë dhe të mësojnë. Zyra e KVINFO-s në Kopenhagë ka realizuar 124 bashkime të reja në çifte gjatë periudhës 1 janar deri 15 mars 2013. Prej këtyre 124 çifteve, 86 prej tyre kanë vazhduar marrëdhënien e mentorimit pas takimit të parë.

 **E dyta**, dërgohet porosia elektronike me të cilën konfirmohet bashkimi.



E nderuara {nxënëse / mentore}

Që të dyja më keni lajmëruar se do të dëshironit që të vazhdonit marrëdhënien e mentorimit. Ju lus që të vendosni kontakt dhe të merreni vesh për datën e takimit të ardhshëm.

Jam e ngarkuar për zhvillimin e procesit të mentorimit në rastin tuaj, gjë që do të thotë se do ta përcjellë marrëdhënien tuaj të mentorimit gjatë periudhës njëvjeçare dhe se gjithmonë do jeni të mirëpritura nëse më lajmëroheni dhe po që se do t'ju nevojitet ndihma ime. Nga ju do të kërkoj informatën kthyesë për përvojat tuaja në lidhje me mentorimin gjatë tre muajve të ardhshëm.

Bashkangjitur ju dërgojmë marrëveshjen për mentorimin dhe formularin e planit të aktiviteteve/realizimit të synimeve, që duhet t'i plotësoni së bashku në takimin e ardhshëm. Luteni që nëpërmjet postës elektronike të më dërgoni, gjatë tri javëve të ardhshme, nga një kopje të të dy dokumenteve.

Me respekt,

*Koordinatorja
Rrjeti i mentorimit*

Nëse mentorja dhe nxënësja nuk i paraqiten koordinatores, ajo do të duhej t'u lajmërohej atyre nëpërmjet postës elektronike ose telefonit dhe t'i pyes: A jeni duke e përgatitur marrëveshjen për mentorim dhe planin e aktiviteteve? A jeni takuar herën e dytë? A do ta vazhdoni këtë proces?


Koordinatorja, po ashtu, duhet ta caktojë datën e re për verifikim brenda tre muajsh dhe ta shënojë në fushën përkatëse të bazës së të dhënave. Mentores dhe nxënëses duhet t'u bëhet me dije se gjithmonë mund t'i drejtohen koordinatores për ndonjë këshillë ose orientim.

Koordinatorja e ndryshon edhe njëherë statusin në bazën e të dhënave për çdo profil individual

Ndryshimi i statusit

nga «E GATSHME PËR BASHKIM NË ÇIFT»

në «NË MARRËDHËNIE MENTORIMI»

 **E treta**, porosinë elektronike pastaj sërisht dërgohen pas tre muajsh dhe pas nëntë muajsh.



E nderuara {nxënëse / mentore}


Kaluan tre muaj/nëntë muaj nga fillimi i marrëdhënies suaj të mentorimit. Po ju shkruaj për të ndjekur zhvillimin e marrëdhënies suaj.

Marrëdhënia e juaj formale në cilësinë e mentores dhe nxënëses në kuadër të programit tonë është planifikuar të zgjasë një vit, kështu që pas X muajve më nuk do jem e ngarkuar me rastin tuaj. Natyrisht, ju mund të vazhdoni të shiheni nëse dëshironi.

Ju lus që të më përgjigjeni në këtë porosi brenda afatit prej 14 ditësh dhe të më njoftoni se në çfarë mase i keni realizuar synimet fillestare, dhe të ma jepni një përshkrim të shkurtër të procesit të mentorimit. Po ashtu, do të ju mirëpres të më lajmëroheni nëse keni ndonjë pyetje.

Me respekt,

*Koordinatorja
Rrjeti i mentoreve*

 **E katërta**, ju dërgohet porosia elektronike përfundimtare (si dhe formulari për evaulim) përafërsisht një vit pas dërgimit të porosisë elektronike për bashkim.



E nderuara {nxënëse / mentore}

Tanimë një vit jeni çift në Rrjetin e mentorimit dhe po përfundon marrëdhënia e juaj formale e mentorimit. Kjo do të thotë se unë më nuk jam e ngarkuar për përcjelljen e rastit tuaj dhe më nuk do t'ju lajmërohem me kërkesë që të m'i dërgoni informatat për marrëdhënien tuaj.

Përvoja jonë tregon se shumica e çifteve arrijnë që brenda afatit prej një viti t'i realizojnë synimet, përkatësisht qëllimet e veta fillestare. Pas kësaj, nëse dëshirojnë mund ta vazhdojnë marrëdhënien e mentorimit në mënyrë të pavarur; disa e ndërprejnë këtë marrëdhënie, ndërsa tek disa të tjera kjo marrëdhënie shndërrohet në miqësi. Në shumicën e rasteve, që nga atëherë më nuk ekziston nevoja që rrjeti i mentoreve të vazhdojë përcjelljen e rastit. Mirëpo, nëse konsideroni se edhe më tutje keni nevojë për orientim ose përkrahje, lirisht mund të më lajmëroheni.

Ju lus që të më përgjigjeni se a dëshironi që edhe më tutje të vazhdoni të jeni në rrjetin e mentoreve, qoftë si mentore aktive ose si nxënëse, dhe sërish dëshironi të bashkoheni në çift.


Po ashtu, mund të përcaktoheni që edhe më tutje të jeni pjesë e rrjetit dhe të merrni informata për ngjarjet dhe kurset si „pjesëmarrëse në rrjet“.

Me respekt,

*Koordinatorja
Rrjeti i mentoreve*

VLERËSIMI

Koordinatorja duhet të kujtohet dhe ta caktojë një datë të re për verifikim, pas dy javësh, dhe ta shënojë në fushën përkatëse në bazën e të dhënave. Shkaqet për ndërprerjen e marrëdhënies së mentorimit duhet të shënohen në fushën për vërejtje. Koordinatorja, po ashtu, duhet ta ndryshojë statusin e mentores dhe të nxënësës në profilet individuale.

 Nëse formulari për vlerësim nuk kthehet brenda afatit prej dy javësh, dërgohet përkujtuesi. Këtë herë, koordinatorja duhet të kujtohet që ta caktojë një datë të re për verifikim pas një jave, dhe ta shënojë në fushën përkatëse në bazën e të dhënave. Nëse formularët për vlerësim nuk kthehen brenda një jave, koordinatorja duhet ta thërras çiftin e mentoruar dhe të kërkojë prej tyre që ato t'i dërgojnë.



Shembulli i vlerësimit që e ka dhënë mentorja

E nderuara mentore,

Ju falemnderit që i keni ndarë pesë minuta që së bashku me ne të jepni mendimin për procesin e mentorimit. Komentet tuaja do t'i trajtojmë në tërësi si të besueshme dhe në to do të ketë qasje vetëm personeli i Rrjetit të mentoreve.

Ju dëshiroj gjithë të mirat.

Koordinatorja

Rrjeti i mentoreve

Data:

Si quheni?

Si quhet nxënësja juaj?

Si quhet personi juaj për kontakt në Rrjetin e mentoreve?

A ka përfunduar procesi i mentorimit? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

Po

Jo, vazhdoj të punoj me nxënësen time.

>>

Pse ka përfunduar procesi i mentorimit? - Shënojeni të gjitha përgjigjet përkatëse -

- Nxënësja i ka realizuar synimet e veta
- Periudha njëvjeçare ka skaduar
- Partneriteti më nuk mund të ofrojë kurrfarë kontributi
- Më nuk takohemi ose nuk mbajmë kontakte
- Pikësynimet tona në procesin e mentorimit nuk janë përputhur
- E kishim të vështirë ta kuptojmë njëra tjetrën
- Jemi bër mike dhe tani shoqërohemi
- Situata e nxënësës ose situata ime ka ndryshuar (ndryshimi i adresës, puna e re, edukimi/trajnimi i ri, pushimi i lehonisë, divorci ose diçka tjetër)
- Të tjera

Sa shpesh dhe në çfarë mënyre keni realizuar kontaktin me nxënësen tuaj?

- Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Njëherë në muaj apo më shpesh Më rrallë se njëherë në muaj Asnjëherë

Si keni kontaktuar më së shpeshti? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Personalisht
- Kontakti nëpërmjet postës elektronike, telefonit, porosive SMS, Fejsbukut ose nëpërmjet mediave të tjera shoqërore

Çfarë përfitimi keni pasur nga fakti se keni qenë mentore? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Jam bërë me e vetëdijshme për barrierat dhe sfidat me të cilat mund të ballafaqohet nxënësja ime
- E kam zgjeruar rrjetin tim duke i përfshirë në të edhe gratë, prejardhja etnike e të cilave nuk është daneze
- Kam ndihmuar një grua tjetër që të bëjë hapa pozitivë
- Kam mësuar dhe jam zhvilluar nga puna që e kam kryer si mentore
- Përvoja e tërësishme ka qenë pozitive
- Të tjera

A e keni zgjeruar rrjetin tuaj? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Po, në masë të madhe Po, në një farë mase
 Jo, jo aq shumë Jo, aspak Nuk e di

Në çfarë mase keni qenë të kënaqur me orientimin dhe përcjelljen nga

Rrjeti i mentoreve? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Jam shumë e kënaqur E kënaqur Neutrale
 E pakënaqur Shumë e pakënaqur Nuk e di



Si do ta përshkruanit marrëdhënien ndërmjet jush dhe nxënëses suaj?

- Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Shumë të mirë Të mirë Neutrale Të keqe Nuk e di

Nëse dëshironi diçka të shtoni për atë çka keni përfituar nga puna juaj si mentore, këtë mund ta shënoni këtu.

Ju falënderojmë për informatën kthyesë!



Shembulli i **vlerësimit që e ka dhënë nxënësja**

E nderuara nxënëse,

Ju falemnderit që i keni ndarë pesë minuta që së bashku me ne ta jepni mendimin për procesin e mentorimit. Komentet tuaja do t'i trajtojmë në tërësi si të besueshme dhe në to do të ketë qasje vetëm personeli i Rrjetit të mentorëve.

Ju dëshiroj gjithë të mirat.

Koordinatorja

Rrjeti i mentoreve

Data

Si quheni?

Si quhet nxënësja juaj?

Si quhet personi juaj për kontakt në Rrjetin e mentoreve?

A ka përfunduar procesi i mentorimit? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Po Jo, vazhdoj të punoj me nxënësen time.

>>

Pse ka përfunduar procesi i mentorimit? - Shënojeni të gjitha përgjigjet përkatëse -

- Nxënësja i ka realizuar synimet e veta
- Periudha njëvjeçare ka skaduar
- Partneriteti më nuk mund të ofrojë kurrfarë kontributi
- Më nuk takohemi ose nuk mbajmë kontakte
- Pikësynimet tona në procesin e mentorimit nuk janë përfunduar
- E kishim të vështirë ta kuptojmë njëra tjetrën
- Jemi bërë mike dhe tani shoqërohemi
- Situata e nxënësës ose situata ime ka ndryshuar (ndryshimi i adresës, puna e re, edukimi/trajnimi i ri, pushimi i lehonisë, divorci ose diçka tjetër)
- Të tjera

Sa shpesh dhe në çfarë mënyre keni realizuar kontaktin me nxënësen tuaj?

- Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Njëherë në muaj apo më shpesh
- Më rrallë se njëherë në muaj
- Asnjëherë

Si keni kontaktuar më së shpeshti? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Personalisht
- Kontakti nëpërmjet postës elektronike, telefonit, porosive SMS, Fejsbukut ose nëpërmjet mediave të tjera shoqërore

Çfarë përfitimi keni pasur nga fakti se keni qenë mentore?

- Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Jam bërë me e vetëdijshme për barrierat dhe sfidat me të cilat mund të ballafaqohet nxënësja ime
- E kam zgjeruar rrjetin tim duke i përfshirë në të edhe gratë, prejardhja etnike e të cilave nuk është daneze
- Kam ndihmuar një grua tjetër që të bëjë hapa pozitiv
- Kam mësuar dhe jam zhvilluar nga puna që e kam kryer si mentore
- Përvoja e tërësishme ka qenë pozitive
- Të tjera

A e keni zgjeruar rrjetin tuaj? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Po, në masë të madhe
- Po, në njëfarë mase
- Jo, jo aq shumë
- Jo, aspak
- Nuk e di

>>

Në çfarë mase keni qenë të kënaqur me orientimin dhe përcjelljen nga Rrjeti i mentoreve? - Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Jam shumë e kënaqur E kënaqur Neutrale
 E pakënaqur Shumë e pakënaqur Nuk e di

Si do ta përshkruanit marrëdhënien ndërmjet jush dhe nxënëses suaj?

- Shënojeni vetëm një përgjigje -

- Shumë të mirë Të mirë Neutrale Të keqe Nuk e di

Nëse dëshironi diçka të shtoni për atë çka keni fituar nga puna juaj si mentore, këtë mund ta shënoni këtu.

Ju falënderojmë për informatën kthyesë!

BAZA E TË DHËNAVE TË MENTORIMIT KVINFO

Organizata KVINFO ka hartuar formularin e bazës së të dhënave në gjuhën daneze dhe angleze.

Nëse dëshironi ta shfrytëzoni bazën e të dhënave si ndihmesë për krijimin e rrejtit tuaj të mentoreve, është me rëndësi t'i shqyrtoni katër gjëra.

Interneti si vend i punës:

A është praktike që të shfrytëzohet baza e të dhënave në internet si vegël e besueshme? Sa është i qëndrueshëm interneti në lokacionin tuaj? A e kanë shumica e mentoreve dhe nxënësve postën elektronike dhe lidhjen e internetit?

Mbajtja e bazës së të dhënave në server (hosting):

A e kemi serverin përkatës për bazën e të dhënave? A e kemi ekspertin e informatikës i cili di si të instalohet dhe të mirëmbahet baza e të dhënave? A e kemi me këtë ekspert të informatikës marrëveshjen për dhënien e ndihmës, po që se diçka nuk shkon si duhet?

Dokumentacioni dhe hartimi i raporteve:

A e përfshini në raportet tuaja analizën statistikore? Çfarë të dhënash dëshironi të keni në raporte?

Instalimi dhe vendosja e bazës së të dhënave për mentorimin KVINFO nënkupton:

- Serveri-Web
- Është i instaluar PHP 5 /MySQL dhe Apache 2
- Qasja në instalim dhe çpaketimi i bazës së të dhënave (privilegji i qasjes)
- Rregullimi i kohës, konfigurimi dhe përshtatja e mjeteve nevojave individuale.

BARTJA E PËRVOJAVE NË RRJETIN E MENTOREVE: PRANIA NË MEDIAT DIGJITALE

Ekipi për komunikim i organizatës e ka rolin kyç në zhvillimin e Rrjetit të mentoreve dhe shpesh bashkëpunon me koordinatorët me qëllim të vendosjes së komunikimit dhe të strategjisë së depërimit deri te shfrytëzuesit. Plani i komunikimit duhet të merr parasysh nevojat e mentores dhe të nxënëses si dhe përvojat e tyre rreth shërbimeve që i ofron Rrjeti i mentoreve e, po ashtu, duhet të përfshijë edhe vizionin e organizatës.

Teknologjia bashkëkohore e ka ndryshuar mënyrën në të cilën Rrjeti i mentoreve KVINFO zhvillohet dhe komunikon. Ekipi për komunikim i KVINFO-s është përgjegjës për prezencën në mediat digjitale, për prezantimet në internet dhe për buletin informativ, si edhe për prezantimin në TV, radio dhe në shtyp. KVINFO nuk reklamohet dhe nuk rekruton zyrtarisht mentore dhe nxënëse. Së këndejmi, prania në mediat digjitale sot është po aq e rëndësishme ashtu siç kanë qenë dikur të rëndësishme materialet e shkruara.

Ekipi për komunikim i KVINFO-s e ka zhvilluar brendin për Rrjetin e mentoreve, logon dhe sloganet. Një hap tjetër i Rrjetit të mentoreve KVINFO ka qenë zhvillimi i rrjeteve sociale, siç janë Fejsbuk, YouTube dhe Twitter. Mirëpo, duhet siguruar që ato të shfrytëzohen në mënyrën përkatëse dhe në pajtim me rregullat e qarta.

Në vazhdim po i japim disa këshilla për një punë më të mirë ekipore ndërmjet ekipit për komunikim dhe koordinatorëve të Rrjetit të mentoreve:

- **Zhvillojeni një metodologji të qartë të punës.** Komunikimi mund të jetë kompleks dhe i domosdoshëm brenda një periudhe të shkurtër kohore, andaj është me rëndësi që të caktohet në mënyrë të qartë vëllimi i komunikimit dhe i pritshmërive lidhur me rezultatet. Në këtë mënyrë procesi do jetë transparent dhe do të mund të menaxhohet lehtë.
- **Merruni vesh për mjetet e komunikimit.** Duhet të ekzistojë marrëveshja për kanalet e komunikimit me mentorët, nxënëset dhe me palët e tjera të interesuara.
- **Gjithmonë përpiquni që përmbajtja kryesore në kanalet e komunikimit të jetë koncize dhe informuese, e besueshme dhe e thjeshtë për përcjellje.**

UDHËZUESI PËR ORGANIZIMIN E PUNËTORISË HYRËSE PËR NXËNËSE

Koordinatorja përshëndet të pranishmit dhe secilës nxënës ia jep rastin që ta thotë emrin e vet dhe kur është bërë pjesë e Rjetit. Pastaj shpjegon se qëllimi i punëtorisë është që pjesëmarrëset t'i përgatis për rolin e nxënëses.

Koordinatorja e prezanton shkurtimisht strukturën e punëtorisë. Në tabelë i prezanton rrëfimin jetësor dhe tri tërësi:

MODULI 1: Ëndërrat dhe vizionet e jetës së nxënëses.

MODULI 2: Nxënëset dhe mentoret – rolet në marrëdhënien e tyre.

MODULI 3: Nxënëset dhe Rrjeti i mentoreve.

Çifti i mentoreve me përvojë prezanton rrëfimin e vet si studim i rastit. Flasin për sa vijon:

Me çfarë çështjesh dhe sfidash janë ballafaquar mentorja dhe nxënësja gjatë marrëdhënies së mentorimit?

Si e ka mbështetur ose si e ka inspiruar mentorja nxënësen që ta ndihmojë vetveten?

Çfarë ishte më së vështiri?

Çfarë ishte argëtuese?

Çfarë i ka befasuar?

Çfarë është tani gjendja?

Çfarë ka përfituar çifti deri tani nga kjo marrëdhënie?

Koha në dispozicion për pyetje dhe komente të pjesëmarrëseve për çiftin e mentoruar.

Koordinatorja e falënderon çiftin e mentoruar për pjesëmarrje.

Koordinatorja prezanton **MODULIN 1:**

Pastaj Fasilitatorja i ndanë letrat në të cilat janë shkruar fjalët „Ëndërra ime është që ...“ dhe lapsat.



Vazhdojmë të përqëndrohemi në ëndërrat dhe vizionet tuaja që do të donit t'i realizoni. Tani ëndërrat dhe zotësia juaj që t'i verbalizoni janë më të rëndësishmet për marrëdhënien tuaj. Pastaj një pjesë të kohës ia kushtojmë pyetjes – si mund t'i realizoni këto ëndërra me ndihmën e mentores.

Gjatë pesë minutave të ardhshëm ju do të përpiqeni që vetë të shkruani se cilat janë ëndërrat tuaja momentalisht. Çfarë dëshironi në jetën tuaj pikërisht në këtë çast. Do të jua bëj me dije kur të kalojnë këta pesë minuta.

Pas kalimit të kohës prej pesë minutash, nga nxënëset do të kërkohet që njëra pas tjetrës të ngrihen në këmbë dhe ta lexojnë me zë atë që e kanë shkruar në letrat e tyre.

Koordinatorja i mbledhë të gjitha letrat dhe i vendos në tabelë.

Koordinatorja hap diskutimin plenar:



Tani kur kemi shumë ëndërra në këtë tabelë, shtrohet pyetja se si ju, si nxënëse, mund t'i realizoni këto ëndërra me ndihmën e mentores suaj.

Koordinatorja e paraqet në mënyrë grafike procesin nëpër të cilin kalojnë mentorja dhe nxënësja: formulimi a) i ëndërrës ose i synimit; b) i ngjarjeve ose i synimeve kyçe; dhe c) i aktiviteteve.

Koordinatorja e merr për studim rastin - një (eventualisht dy, nëse ka kohë të mjaftueshme) prej atyre që gjenden në tabelë – dhe i lidhë me procesin të cilin sapo e ka paraqitur. I përfshinë edhe nxënëset të cilat i pyet se si këto ëndërra mund të realizohen sipas mendimit të tyre. Në këtë mënyrë nxënëset nxiten që ta

japin mendimin e vet. Koordinatorja shpjegon gjatë diskutimit plenar se ëndërrat dhe synimet mund të ndryshojnë me kohë dhe se ëndërrat mund të bëhen realitet në shumë mënyra. Koordinatorja e prezanton marrëveshjen e mentorimit dhe planin e aktiviteteve të cilat i paraqet në slajd: Rrjeti i mentoreve ka përgatitur disa mjete specifike për çiftet e mentorimit si ndihmesë në procesin e realizimit të synimeve dhe ëndërrave. Koordinatorja e shpjegon marrëveshjen e mentorimit dhe planin e aktiviteteve dhe ua jep disa shembuj të pjesëmarrëseve të tjera.


Koordinatorja e mbyllë diskutimin për marrëveshjen e mentorimit dhe planin e aktiviteteve duke theksuar se për planin gjithmonë është përgjegjëse nxënësja, ndërsa mjetet zbatohen gjithëherë në bashkëpunim të ngushtë me mentoren. Koordinatorja e përfundon modulën dhe e lidhë me atë të radhës duke i prezantuar përvojat e Rrjetit të mentoreve në lidhje me sfidat që shfaqen në përpjekjet për realizimin e ëndërrave:



Duhet ta përfundojmë diskutimin për këtë modul por më parë do të doja t'i thoja disa fjalë për përvojat tona sa u përket sfidave me të cilat mund të përballlet çifti i mentoruar në procesin e realizimit të ëndërrave të nxënësës.

Për çiftin e mentoruar sfidë shpeshherë mund të jetë vetëm arritja e marrëveshjes për atë se çfarë është e mundur të realizohet dhe për atë se a është një ëndërr reale apo jo. Po ashtu, mund të ndodhë që mentorja të konsiderojë se nxënësja ka pritshmëri tepër të mëdha nga vetvetja dhe nga marrëdhënia e tyre. Ose anasjelltas, nxënësja mund të konsiderojë se mentorja shtron kërkesa ose ka aspirata tepër të mëdha në emër të nxënësës (mundësisht të jepen shembuj).

Arritja e mirëkuptimit dhe e pajtimit të ndërsjellë për të gjitha çështjet është parakusht në shumicën e marrëdhënieve të mentorimit. Shpeshherë mund të shfaqen kundërtënie ndërmjet asaj që ju nxënësja ëndërroni dhe asaj që mentoret tuaja e vlerësojnë. Mirëpo, bisedat për këto çështje ndërmjet mentores dhe nxënësës shpeshherë janë pozitive dhe nxitëse, dhe ndihmojnë në realizimin e synimeve dhe qëllimeve fillestare. Natyrisht, lidhur me këtë është e nevojshme që mentorja dhe nxënësja të zhvillojnë dialog të hapur dhe të kenë mirëkuptim për pritshmëritë e tjetrës.

 **Koordinatorja fillon me MODULIN 2** duke i prezantuar shkurtimisht rolet në programin e mentorimit – kjo është një marrëdhënie me detyrime të ndërsjella në të cilën me rëndësi më të madhe janë komunikimi dhe dialogu. Sa më të vetëdijshme të jenë mentoret dhe nxënëset për rolin e vet, aq më i lehtë do të jetë dialogu:



Deri tani jemi përqëndruar në ëndërrat dhe vizionet individuale, ndërkaq kemi biseduar edhe për atë se si t'i realizoni ëndërrat tuaja në bashkëpunim me mentoret. Moduli pasues i këtij kursi merret më konkretisht me marrëdhënien tuaj me mentoret. Kur jeni pjesë e programit të mentorimit ju merrni përsipër rolin e nxënëses ose të mentores.

Tani do të përqëndrohemi në atë se si ju e shihni rolin e mentores dhe rolin e nxënëses. Luteni që në grupe të vogla të bisedoni për rolin e mentores dhe për rolin e nxënëses.

Koordinatorja i ndanë pjesëmarrëset në grupe më të vogla dhe kujdeset për kohën. Koordinatorja i thërret grupet, një nga një, që të raportojnë për pikëpamjet e tyre lidhur me rolet në fjalë. Koordinatorja i shënon në tabelë mendimet e shprehura. Koordinatorja në fund i pyet nxënëset se a ka ndonjë befasi, pritshmëri jokonsekvente, pritshmëri jorealiste për nxënësen ose mentoren.



Tani i keni prezantuar idetë e juaja për rolin e mentores dhe rolin e nxënëses, ndërkaq unë dëshiroj që ta përfundoj këtë modul duke i prezantuar idetë tona për rolet e bazuara në përvojën tonë si koordinatorë në marrëdhënie të ndryshme të mentorimit.

Koordinatorja i shpërndanë materialet në të cilat janë paraqitur rolet e mentores e të nxënëses dhe i shpjegon ato. Po ashtu, vë në pah se çka nuk pritet nga mentorja e as nga nxënësja.

Shih shembullin e Skenarit për nxënëse në Aneksin 2 të Rrjetit të mentoreve KVINFO

(fq. 47)

Në fund koordinatorja bën një prezantim të Rrjetit të mentoreve në kuadër të **MODULIT 3**.



Çfarë mund të përfitoni më së shumti si nxënëse në Rrjetin e mentoreve? Si mund të shfrytëzoni koordinatorin dhe të tjerët në rrjet për t'i realizuar synimet tuaja? Dëshira jonë është që t'ua mundësojmë që ta ndjeni pozitën tuaj si nxënëse në Rrjetin e mentoreve, në mënyrë që të përfitoni maksimalisht nga kjo përvojë.

Këto janë disa prej fakteve: Koordinatorja ofron informata për numrin e nxënësve, numrin e mentoreve, numrin e zyrave në Danimarkë, llojin e aktiviteteve për rrjetim, llojin e punëtorive dhe seminareve që organizohen për këtë qëllim, llojin e nënrrjeteve ekzistuese etj.

Koordinatorja bën përmbledhjen e pyetjeve, komenteve dhe të diskutimeve që zhvillohen në atë mbrëmje dhe prezanton ushtrimin përfundimtar:



Tani duhet ta përfundojmë punëtorinë dhe do të dëshiroja që të mendoni për atë që keni dëgjuar sonte dhe të përqëndroheni në atë që e keni mësuar për rolin e nxënëses.

Koordinatorja i vendosë 6 kartona me tekst të shtypur i cili përmban pikëpamjet për rolin kryesor të nxënëses dhe dy kartona të zbrazët në rrethin e madh në dysheme. Në kartona janë shënuar këto role:

Nxënësjat:

1. Përcakton planin, 2. Flet për veten / ëndërrat e veta, 3. Cakton synimet, 4. Është e sjellshme dhe kritike, 5. Është proaktive.

Pjesëmarrëset udhëzohen se duhet t'i zgjedhin ato deklaratat për të cilat mendojnë se janë më të rëndësishmet për rolin e nxënëses, e nëse konsiderojnë se ka diçka edhe më të rëndësishme, atëherë atë do ta shënojnë në kartonat e zbrazët. Pjesëmarrëset pastaj do të bisedojnë për disa minuta me pjesëmarrëset e tjera lidhur me atë se si duhet t'i caktojnë prioritetet ndërmjet kartonave dhe pse mendojnë se disa deklaratat janë më të rëndësishme sesa të tjerat. Koordinatorja e thërret secilin grup që t'u tregojë të tjerëve se për çka kanë biseduar në grup.

Nëse ka kohë të mjaftueshme, ushtrimi sërish fillon me deklaratën tjetër më të rëndësishme e kështu me radhë. Koordinatorja u jep mundësinë pjesëmarrësve që lirshëm të shprehen, gjë që është jashtëzakonisht e rëndësishme për pjesëmarrëset në program. Koordinatorja i falënderon të gjithë për pjesëmarrjen dhe ua shpërndanë fletat për vlerësim.

UDHËZUESI PËR ORGANIZIMIN E PUNËTORISË HYRËSE PËR MENTORE

Koordinatorja i përshëndet të pranishmit dhe sëcilës pjesëmarrëse ia jep rastin që ta thotë emrin e vet, profesionin dhe kur është bërë pjesë e Rrjetit të mentoreve.

Pastaj shpjegon se synimi i punëtorisë është që të përgatis pjesëmarrëse për rolin e mentores, t'i inspirojë dhe t'u japë ide se si ta fillojnë sa më mirë marrëdhënien e mentorimit. Koordinatorja me pak fjalë e paraqet strukturën e punëtorisë dhe në tabelë e paraqet studimin e rastit dhe katër tërësi:

MODULI 1: Takimet ndërkulturore në praktikë

MODULI 2: Dilemat dhe zgjidhjet

MODULI 3: Mjetet

MODULI 4: Për Rrjetin e mentoreve

Çifti i mentoreve me përvojë prezanton rrëfimin e vet si studim i rastit.
Flasin për sa vijon:

Me çfarë çështjesh dhe sfidash janë ballafaquar mentorja dhe nxënësja gjatë marrëdhënies së mentorimit?

Si e ka mbështetur ose si e ka inspiruar mentorja nxënësen që ta ndihmojë vetveten?

Çfarë ishte më së vështiri?

Çfarë ishte argëtuese?

Çfarë i ka befasuar?

Çfarë është tani gjendja?

Çfarë ka përfituar çifti deri tani nga kjo marrëdhënie?

Koha në dispozicion për pyetje dhe komente të pjesëmarrëseve për çiftin e mentoruar.

Koordinatorja e falënderon çiftin e mentoruar për pjesëmarrje.

MODULI 1 është i përqëndruar në takimet ndërkulturore në praktikë.

Koordinatorja e zhvillon bisedën lidhur me «**Pikëpamjet për paragjykimet personale**». Është mirë që ushtrimi të fillojë me shembuj të disa paragjykimeve që i ka vetë:



Mendoni për disa paragjykime ose mendime të gabuara që ndoshta i keni. Mendoni për atë se ndoshta këto paragjykime janë ato që do të donit t'i veni në pah në marrëdhënien e mentorimit dhe sa do ishte kjo e vështirë për ju. Mendoni për këtë vetëm një minut, e pastaj analizojini këto mendime tuaja me mentoren e cila është ulur pranë jush.

Koordinatorja pastaj kërkon nga mentoret që së bashku me të tjerat ta analizojnë atë për çka kanë biseduar.

Koordinatorja prezanton MODULIN 2 për dilemat dhe zgjidhjet:

Pjesëmarrëset ndahen në grupe me nga 3-4 mentore. Koordinatorja i jep secilit grup një numër rastesh të shënuara në letër (shih në vazhdim). Rastet kanë të bëjnë me çështje të ndryshme që mund të paraqiten gjatë marrëdhënies së mentorimit dhe nga grupet kërkohet që gjatë 20 minutave të ardhshëm të bisedojnë për së paku dy raste.

RASTI 1

Koordinatorja juaj ju ka thënë se nxënësja duhet të kontaktojë me ju dhe që ta marrë iniciativën për caktimin e takimit të parë. Mirëpo, nxënësja nuk po ju lajmërohet. Si reagoni?

RASTI 2

Ju dhe nxënësja juaj keni pasur disa takime dhe keni ndjenjën se jeni ju ajo që cakton planin e punës së ardhshme, e jo nxënësja. Çfarë veproni lidhur me këtë çështje?

RASTI 3

Ju dhe nxënësja juaj jeni takuar njëherë dhe ju është nevojitur shumë kohë për të planifikuar këtë takim. Nxënësja juaj tani e shtynë takimin e dytë ngase momentalisht është mjaft e zënë me arsimimin e vet dhe me punët e shtëpisë. Si reagoni në lidhje me këtë?

RASTI 4

Nxënësja juaj ka filluar ta vijoje trajnimin për dizajnere të modës, por nuk e ka kryer. Tani dëshiron ta hapë shitoren e vet, por në këtë fushë nuk ekziston rrjeti. Ka refuzuar të punojë me dizajnerin i cili e ka punën e rregulluar, ngase dëshiron ta ketë shitoren e vet. Tani e kërkon ndihmën tuaj si mentore. Si reagoni ndaj pritshmërive të nxënëses suaj?

RASTI 5

Nxënësja thotë se e ka të vështirë që në shtëpi t'i kryejë detyrat që i merr në shkollë. Për këtë arsye kërkon nga ju që ta ndihmoni se si të veprojë. Si do ta ndihmoni nxënësën në këtë situatë?

RASTI 6

E keni një nxënësë dhe jeni shumë e kënaqur me të. Mirëpo, ekziston një problem. Ajo shpeshherë shtron pyetje personale dhe përzihet në çështjet që, sipas mendimit tuaj, janë plotësisht private?

Nga secili grup kërkohet që të përqëndrohet në dy raste konkrete (të cilat i cakton koordinatorja). Nëse grupi ka kohë të mjaftueshme mund të vazhdojë menjëherë të bisedojë për rastet e tjera. Koordinatorja i informon grupet se kanë 20 minuta kohë të bisedojnë për rastet e ndryshme. Pas 20 minutash koordinatorja i tubon pjesëmarrëset, e hapë diskutimin plenar lidhur me atë se çfarë përgjigjesh kanë dhënë grupet në pyetjet e shtruara për rastet e caktuara.

Si janë përgjigjur grupet veç e veç në pyetjet e shtruara për rastet? A ekziston një apo më shumë përgjigje në pyetjet për këto raste? A pajtohen grupet me përgjigjet e grupeve të tjera në pyetjet për rastet e veçanta?

 Në **MODULIN 3** koordinatorja paraqet në slajd marrëveshjen e mentorimit dhe planin e aktiviteteve.



Në Rrjetin e mentoreve kemi përgatitur disa mjete tejet specifike për ju dhe nxënëset si ndihmesë në procesin e realizimit të synimeve dhe ëndërrave tuaja.

Koordinatorja e shpjegon marrëveshjen e mentorimit dhe planin e aktiviteteve dhe i jep disa shembuj të pjesëmarrëseve të tjera. Fasilitatorja e përfundon prezantimin duke e vënë në pah lidhjen ndërmjet marrëveshjes së mentorimit dhe planit të aktiviteteve. Ajo sqaron se për planin gjithmonë është përgjegjëse nxënësja, ndërsa mjetet zbatohen gjithherë në bashkëpunim të ngushtë me mentoren.

Pastaj, koordinatorja e fillon ushtrimin në kuadër të të cilit jep shpjegime lidhur me hartimin e marrëveshjes dhe të planit të aktiviteteve.

Koordinatorja i ndanë pjesëmarrëset në çifte dhe kërkon prej tyre që ta luajnë rolin e mentores dhe të nxënësës. Tani çifti ka për detyrë t'i bashkojë dy mjete sipas dëshirës dhe nevojës së nxënësës.

Koordinatorja kujdeset për kohën. Çiftet kanë në dispozicion 15 minuta që ta kryejnë ushtrimin.

Koordinatorja e fillon bisedën duke kërkuar vullnetare të cilat do t'i komentojnë përfundimet e veta: A dëshiron ndonjëra prej jush të na tregojë se si e ka kryer ushtrimin?

Koordinatorja e përfundon modulin duke i theksuar përvojat e Rrjetit të mentoreve me marrëveshjen e mentorimit dhe planin e aktiviteteve dhe mënyrën se si mentoret i kanë shfrytëzuar.

Pastaj e ndërlidhë temën me modulin pasues duke e prezantuar Rrjetin e mentoreve me ndihmën e power point.

MODULI 4 trajton lidhjen me Rrjetin e mentoreve.

Moduli 4 ofron informata të rëndësishme për Rrjetin e mentoreve. Është mirë që mentoret të njihen me madhësinë dhe fushën e veprimit të rrjetit, në mënyrë që të kuptojnë se si edhe ato vetë do të kenë dobi nga kjo përvojë. Koordinatorja ofron informata për numrin e nxënësëve, numrin e mentoreve, numrin e zyrave në Danimarkë, llojin e aktiviteteve të rrjetëzimit, llojin e punëtorive dhe seminareve të organizuara, si dhe për llojin e nënrrjeteve që kanë dalur nga Rrjeti i mentoreve.

Koordinatorja ua mundëson pjesëmarrëseve që lirshëm të përgjigjen në pyetjen – çfarë ka qenë veçanërisht e rëndësishme për pjesëmarrëset në programin e sontëm? Koordinatorja i falënderon të gjithë pjesëmarrësit dhe u shpërndanë fletat për vlerësim.

MENTORIMI DHE RRJETËZIMI NË POLITIKË

Një numër i pamjaftueshëm i grave, sidomos nga radhët e bashkësive pakicë, janë të përfshira në jetën politike; i tillë është rasti në Danimarkë dhe në vendet e tjera të BE. Në vitin 2008/2009 është shënuar njëqindvjetori i të drejtave të grave në Danimarkë që të votojnë në zgjedhjet lokale dhe për zgjedhjen e këshilltareve të para në këshillat vendore. Në kuadër të krenimit, Rrjeti i mentoreve KVINFO, në partneritet me komunën e Kopenhagës, ka marrë pjesë në programin e parë të mentorimit politik të menduar si nxitje për përfaqësimin e barabartë politik dhe pjesëmarrjen e emigranteve në nivel lokal.

Modeli i parë i mentorimit politik përfshinte 15 politikane (mentore) të cilat kanë këshilluar dhe orientuar 15 emigrante (nxënëse) që kanë qenë të interesuara për politikë apo të cilat tashmë kanë qenë të përfshira në politikë në rajonin e gjërë të Kopenhagës. Programi u ofroi një mundësi unike emigranteve në Danimarkë dhe politikaneve në funksionet më të larta nga partitë e ndryshme në parlamentin danez që të njihen dhe bisedojnë për nevojat, opsionet dhe potencialin e tyre. Iniciativa është ndërmarrë më 5 mars 2009 dhe vazhdoi deri në tetor të vitit 2009. Synimet e përmendura kanë përfshirë: nxitjen për pjesëmarrje në politikë nëpërmjet kontakteve me rrjetet kyçe politike; rritja e interesit për politikë ndër iemigrantet nëpërmjet shkëmbimit të dijes dhe përvojave me mentoret; promovimi i dialogut ndërmjet nxënëseve dhe mentoreve me qëllim të rritjes së zotësisë dhe aftësisë për marrjen e vendimeve; nxitjen e një pjesëmarrjeje më të madhe në politikë të emigranteve në zgjedhjet e ardhshme komunale që do të mbahen në vitin 2009. Pesë nxënëse kanë marrë pjesë në zgjedhje, ndërsa tri janë zgjedhur. Iniciativa arriti sukses të madh, kështu që modelin e mentorimit KVINFO tani e shfrytëzojnë Lobi Evropian i Grave (EWL) në mbarë Evropën dhe orgnaitatat e tjera në Jordani, Butan, Tanzani dhe Malavi.

MENTORIMI DHE RRJETËZIMI NË NDËRMARRËSI

Organizatata në Marok dhe Portugali e shfrytëzojnë modelin e mentorimit dhe mjetet KVINFO për t'i përkrahur gratë dhe meshkujt nga grupet e marginalizuara, që ëndërrojnë të bëhen ndërmarrës të suksesshëm. Përvoja e mentorimit synon që nxënëset të fitojnë shkathtësi afariste dhe të ndërtojnë rrjete profesionale. Çiftet punojnë „një për një“ përgjatë një viti për realizimin e synimeve kyçe biznesore dhe për forcimin e frymës ndërmarrëse. Kjo ka për qëllim që nxënëset të aftësohen për të filluar punën në mënyrë të pavarur dhe që ta mbështesin njëra tjetrën si pjesë e një bashkësie të madhe biznesore.

LISTA FINALE E KONTROLLIT PËR FORMIMIN E RRJETIT TË MENTOREVE

Kjo është lista e kontrollit që përfshin disa aktivitete kyçe që duhet të kihet parasysh:

- Janë të qarta qëllimet që rrjeti i mentoreve synon t'i realizojë.
- Janë përcaktuar nevojat e nxënësve – publiku i synuar.
- Janë caktuar mentorët potenciale.
- Janë caktuar nxënëset potenciale.
- Është planifikuar procesi i përcaktimit të nevojave individuale të nxënësës.
- Është planifikuar mënyra e caktimit të shkathësive dhe aftësive individuale të mentores.
- Është përcaktuar mënyra e bashkimit në çift të mentoreve dhe nxënësve.
- Është përcaktuar procesi për ofrimin e vazhdueshëm të informatave dhe mbështetjen e mentoreve dhe nxënësve, përfshirë edhe mënyrën e veprimit mediatik dhe zgjidhjen e konflikteve eventuale.
- Është hartuar plani i trajnimit me qëllim të plotësimit të nevojave të mentoreve dhe nxënësve.
- Janë përcaktuar treguesit kyç të efektivitetit dhe metoda e vlerësimit të marrëdhënies së mentorimit.

Në nivel operativ duhet të keni parasysh edhe sa vijon:

- Korniza kohore për implementimin e rrjetit të mentoreve.
- Buxheti për implementimin e rrjetit të mentoreve.
- Kërkesat logjistike për implementimin e rrjetit të mentoreve (p.sh. privatësia, teknologjia, strategjia e komunikimit).
- Mbështetja e të gjitha palëve relevante të interesuara në implementimin e rrjetit të mentoreve.

MARRËVESHJA E MENTORIMIT

Kjo marrëveshje e mentorimit është lidhur ndërmjet:

Nxënëses

Mentores

Koordinatorja jonë është

Me këtë marrëveshje konfirmojmë pëlqimin tonë lidhur me sa vijon:

- Synimi ynë është që të zhvillojmë marrëdhënie të bazuar në respekt.
- Synimi ynë është që të vendosim dialogun në mënyrë që ta kuptojmë njëra tjetrën lidhur me atë se si i shikojmë gjërat.
- Nëse do kemi vështirësi në marrëdhënien e mentorimit, do përpiqemi që për këtë të bisedojmë dhe të gjejmë zgjidhje.
- Marrëdhënia jonë është e besueshme, gjë që do të thotë se me askend nuk do bisedojmë për përmbajtjen e bisedave tona. Mund të vendosim që pikëpamjet dhe përvojat tona t'i shkëmbejmë me koordinatoren.
- Nuk do të shkëmbejmë dhurata.
- Nuk do presim që tjetra të na thërras ose shkruaj.
- Do ta marrim iniciativën për kontakte të ndërsjella.
- Do t'i përmbahemi marrëveshjes lidhur me takimet.
- Do të përpiqemi që njëra tjetrën ta motivojmë në mënyrë që të arrijmë atë për çka jemi marrë vesh.

Do të takohemi së paku njëherë në muaj. Ndërmjet takimeve do të jemi në kontakt (nëpërmjet porosive SMS, postës elektronike, telefonit, skajpit):

.....

QËLLIMI I MARRËDHËNIES SË MENTORIMIT ËSHTË

(shënojeni më së shumti katër përgjigje)

- Të merret mbështetja për arsimim (dëtyrat e shtëpisë, ndihma etj.)
- Fillimi i arsimimit
- Pranimi si praktikant
- Punësimi
- Punësimi në pajtim me kualifikimet e nxënësës
- Zgjerimi i rrjetit social
- Zgjerimi i rrjetit profesional
- Të sigurohet një qasje më e mirë në kulturën e tregut të punës
- Të përfitohet nga fakti se e kemi dikë me të cilën mund të bisedojmë dhe e cila do na dëgjojë
- Rritja e vetëbesimit në aftësitë vetiake
- Të tjera
-
-
-
-

SKENARI

PËR NXËNËSE

Marrëdhënia e mentorimit me mentoren time do të zgjasë rreth **12 muaj**. **Do të takohem me mentoren time së paku njëherë në muaj** idhe do ta mbajë kontaktin me të gjatë periudhës ndërmjet takimeve tona.

E kam mbajtur mend sa vijon:

Mentorja e kryen këtë punë vullnetarisht. Nuk paguhet të takohet me mua, por këtë e bën ngase dëshiron ta mbështes një grua tjetër.

Mentorja do më mbështes dhe do më jep këshilla në pajtim me ëndërrat dhe synimet e mia në jetë.

Mentorja është partnere për bisedë. Unë vendosi se a do ta pranojë apo jo këshillën e saj. Lidhur me këtë mund të flas lirshëm me mentoren time.

Do bëjë ç'është e mundur për krijimin e një marrëdhënie të mirë mentorimi. Kjo do të thotë se do t'i respektoj marrëveshjet tona për takime, ndërsa që nëse nuk mund të dalë në takim, do ta lajmëroj që takimin ta shtyjmë. Kjo, po ashtu, nënkupton se do të përpiqem që synimet e mia të jenë sa më konkrete dhe të kuptueshme për mentoren time.

Mentorja dhe unë jemi përgjegjëse për zhvillimin e marrëdhënies sonë.

Do të marrë pjesë në punëtorinë hyrëse për nxënëse.

Do të kontaktoj me koordinatoren nëse gjatë marrëdhënies së mentorimit do të hasi në vështirësi dhe sfida.

Do marrë pjesë në ndjekjen dhe vlerësimin e marrëdhënies së mentorimit. Kjo përfshin edhe nënshkrimin e marrëveshjes së mentorimit dhe plotësimin e vlerësimit përfundimtar.

Përvojat dhe sukseset e mia do i shkëmbej me koordinatoren time.

Do të kujdesem që të dhënat e mia për kontaktim të jenë të përditësuara.

ME 57 SHTETE PJESËMARRËSE NË AMERIKËN VERIONE, EVROPË DHE AZI, OSBE ËSHTË ORGANIZATA MË E MADHE RAJONALE NË BOTË PËR ÇËSHTJET E SIGURISË, E CILA ANGAZHOHET PËR SIGURIMIN E PAQES, DEMOKRACISË DHE STABILITETIT PËR MË SHUMË SE NJË MILIARD NJERËZ. OSBE KA NJË QASJE GJITHPËRFSHIRËSE TË SIGURISË DHE MERRET ME NJË SPEKTËR TË GJËRË QË ÇËSHTJEVE TË SIGURISË, PËRFSHIRË EDHE KONTROLLIN E ARMATIMIT, MASAT PËR NDËRTIMIN E MIRËBESIMIT DHE TË SIGURISË, TË DREJTAT E NJERIUT, PAKICAT KOMBËTARE, DEMOKRACINË, STRATEGJITË E PUNËS POLICORE, LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT SI DHE AKTIVITETET EKONOMIKE DHE EKOLOGJIKE.

**Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Departamenti për Barazi Gjinore
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Sekretariati i OSBE-së
Wallnerstrasse 6
1010 Vjenë, Austri
E-mail: equality@osce.org
www.osce.org/gender**



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë